



K.DH.SH.II.nr.1039/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVWS -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare kolegjit, Franciska Zhitija Ymeri dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “IPKO Telecommunications LLC , të cilën sipas autorizimit e përfaqëson I.D, avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson V.P, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1535/18 të datës 10.08.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 13.11.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e bazuar ankesa e të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1535/18 të datës 10.08.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar A.nr.1535/18 të datës 10.08.2021, në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar si të bazuar propozimin e paditësit IPKO Telecommunications LLC- Prishtinë. Ndërsa në pikën II të dispozitivit, anulohet vendimi i të paditurit Organi Shqyrtues i

Prokurimit Publik (OSHP) në Prishtinë, PSH nr. 163/18 të datës 22.05.2018 dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka parashtruar ankesë i padituri Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik, përmes A.B, Kryesuesit të OSHP-së, për shkak të: vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që Dhoma e Shkallës së Dytë të aprovohet ankesa e të paditurit, Organi Shqyrtues i Prokurimit, si e bazuar ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr. 1535/18 të datës 10.08.2021 të anulohet si i pa bazuar dhe njëherit të refuzohet padia dhe kërkesëpafia e paditësit e “IPKO Telecommunications LLC” me seli në Prishtinë, të hidhet poshtë si e pa bazuar.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Dhoma e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore në ankesë lidhur me aktvendimin e atakuar, si dhe vlerësimit komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), lidhur me nenin 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pa-**bazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, me datën 22.06.2018, ka paraqitur padi për anulimin e vendimit - aktit administrativ të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik, PSH.nr.163/18 të datës 22.05.2018, për shkak të interpretimit të gabuar të dispozitave ligjore dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, me aktvendimin A.nr.1535/18, të datës 10.08.2021, e ka aprovuar aprovuar padinë e paditësit si në dispozitiv të aktgjykimit, me arsyetim se vendimi i kontestuar përmban të meta të tilla për shkak të cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat të tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të ligjit për procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA). Vendimi është i përgjithshëm, i paqartë dhe

kundërthënës Gjykata konstaton se e paditura ka vepruar në kundërshtim me nenin 9.4 të LPP kur ka konstatuar se Paneli Shqyrtues duke pasur parasysh faktin që Telekom i Kosovës është autoritet publik dhe ofron shërbime profesionale të natyrës së këtij aktiviteti të prokurimit dhe duke pasur parasysh faktin që Ministria e Zhvillimit Ekonomik si autoritet kontraktues nuk e ka respektuar nenin 9.4 të LPP atëherë ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet në tërësi si dhe të merret për bazë neni 9.4 i LPP-së, për faktin se operatori ekonomik Telekom i Kosovës e ka statusin e Ndërmarrjes Publike dhe është operator ekonomik dhe duhet ti nënshtrohet konkurrencës së lirë, andaj e paditura nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik Barazia në Trajtim/jo Diskriminimi.. Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e të paditurës, por të njëjtat i vlerësoi si të pa bazuara dhe pa ndikim për vendosje ndryshe në këtë çështje juridike, pasi që vendimi i të paditurës i nxjerrë mbi këtë bazë, konsiderohet me të meta, pasi që në procedurën administrative nuk janë respektuar rregullat e procedurës. Të metat të caktuara më lartë janë të atilla që vendimin e atakuar e bëjnë të pa drejtë dhe në kundërshtim me ligjin, respektivisht vendimi i atakuar nuk është i bazuar fare në dispozitat të cilat rregullojnë çështjen këtu të caktuar, andaj gjykata e obligon organin e paditur që në ri procedurë të veproj sipas vërejtjeve në këtë aktgjykim pasi që ti mënjanoj të metat e cekura të merr vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Kolegji i kësaj gjykate e pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar më ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (n), për të cilat Dhoma e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, të zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA -së, po ashtu nuk është i përfshirë as në shkeljet e tjera të nga neni 38 i LKA -së, e as konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se interpretimet e KRPP-së janë respektuar nga ana e OSHP-së dhe në bazë të tyre është krijuar një praktikë që është përkrahur nga sistemi i drejtësisë. Arsyetimi i vendimit të Panelit Shqyrtues është konform ligjit pasiqë për secilin pretendim veç e veç është dhënë përgjigje nga paneli shqyrtues dhe nuk qëndrojnë pretendimet e gjykatës së shkallës së parë se arsyetimi është i mangët dhe jo i qartë. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi, ngase gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të

cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit janë të pa bazuara, ngase të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar dhe në kundërshtim me provat në shkallës e lëndës, meqë pretendimet e paditësit janë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi. Sepse, gjykata e shkallës së parë me të drejtë i është referua nenit 7 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik. Andaj, për këtë arsye gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se padia e paditësit është e bazuar, andaj ka aprovuar kërkesëpadinë, ka anuluar vendimin e të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik OSHP, dhe e ka obliguar të paditurën që në ri procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi ti mënjanoj të metat e cekura të marr vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurit. Prandaj, pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës, për shkak se aktgjykimi i ankimuar ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohet, pasi që i njëjti është kontradiktor me vetveten dhe me arsyetimin, respektivisht arsyet e theksuara në të janë të pa qarta dhe kundërthënëse me faktet, respektivisht provat e paraqitura nga e paditura. Ky kolegji këto pretendime ankimore nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të pa bazuara, përkatësisht të pa argumentuara me prova konkrete, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij i janë dhënë arsyet të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se edhe e drejta materiale është aplikuar drejtë, dhe se nuk është shkelur ligji në dëm të paditurit.

Përfundimisht, Dhoma e Shkallës së Dytë i ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë, por nuk ka gjetur se ekziston ndonjë shkelje e cila do të ndikonte që vendimi të kualifikohet si i tillë për çka çështja pastaj do të duhej të kthehej në rishqyrtim apo të vendoset ndryshe.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

K.DH.SH.II.nr.1039/22, me datë 13.11.2023

**Kryetare e kolegjit,
Saranda Bogaj Sheremeti**